



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË

DREJTORIA E
INTEGRIMIT EVROPIAN
KOMUNIKIMIT DHE TRANSPARENCËS

Nr. 4971 prot.

Lezhë, më 23.03.2021

V E N D I M

Nr. 79 Datë 23 / 03 / 2021

**PËR VENDOSJEN E MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE E EDUKUESE DHE
RREGULLAT PËR AFISHIMIN E TYRE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE**

Bazuar në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1/1.1 shkronja (b), dhe nenit 64, shkronja (a) të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenin 79 të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar”, ligjit 8224 datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës” i azhornuar me ligjin nr.8335 datë 23.04.1998, Vendimit nr.153 date 11.04.2019 të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve “Për përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet per afishimin e tyre gjate fushatës zgjedhore, të Udhëzimit Nr. 6 Datë 23.03.2021 të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

V E N D O S A:

1. Përcaktimin e kriterëve për përdorimin e materialeve propagandistike/edukuese dhe përcaktimin e listës së sendeve apo materialeve të lejuara për fushatë, në zbatim të Udhëzimit nr.6 Datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.
2. Vendet e caktuara për afishim në qytetin e Lezhës janë: Rruga “Bulevardi “Gjergj Fishta”, konkretisht tek hapësira midis shkallëve të Gjykatës dhe të Albtelekomit (aty ku sot janë kabinat telefonike), dhe në qendër të të gjitha njësitë administrative.
3. Vendi për vendosjen e materialeve edukuese, që do të afishohen nga palët e treta, që nuk kanë lidhje me subjektet zgjedhore, është caktuar në çdo holl të zyrave të Gjendjes Civile në Bashkinë Lezhë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: Policia Bashkiake, Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, Inspektoriat i Vendor i Mbrojtjes së Territorit dhe Drejtoria Juridike.

KRYETARI
Pjerin NDREU

